

## INFORMATA MBI GRANTIN

Emri i grantit:	Avokimi për politika kulturore në qytetin e Pejës
Instrumenti:	Grant për projekt
Subjekti zbatues:	Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Pejë - RrOK Peja
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Rr. "Hasan Prishtina", nr. 73, 30 000, Pejë <a href="mailto:rrjetipeja@gmail.com">rrjetipeja@gmail.com</a> +383 44 215 930 <a href="https://www.facebook.com/RrOKP">https://www.facebook.com/RrOKP</a> .
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 01/05/2021 Data e përfundimit: 31/12/2021
Buxheti total i grantit (EUR):	9,393.00 EUR
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	9,393.00 EUR
Grupet e synuara:	Gratë, Të rinjtë, Politikbërësit
Shtrirja gjeografike:	Komuna e Pejës
Përmbledhje e grantit:	<p>Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është avokimi për një qeverisje lokale më transparente dhe të hapur ndaj kërkesave dhe nevojave të qytetarëve, si dhe përfshirja më e madhe e të rinjve në procese vendimmarrëse. Nga realizimi i këtij projekti, të rinjtë do të kenë ide me të qarta mbi funksionimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, rrjedhmisht njoftimi me punën e tyre në nivel afatgjatë krijon mundësi që të rinjtë të jenë më aktivë në adresimin e formulimit e kërkesave të tyre. Rreth 180 të rinj të Komunës së Pejës (gjysma e tyre gra dhe vajza dhe një pjesë prej komuniteteve joshumicë) përgjatë 8 muajve do të marrin pjesë në vizita studimore, do të fuqizohen si avokues të politikave, do të identifikojnë hapësira publike në lagje të ndryshme, do të takohen me politikbërës lokal, si dhe do të marrin pjesë në një fushatë artistike. Në fund të këtij projekti që është mbështetur në vlerën prej 9.390 eurove, pritet që komunikimi mes të rinjve me politikbërësit lokal të rritet, procedura e dhënies së granteve në departamentin e Kulturës dhe Rinisë të strukturohet me një strategji të qartë dhe një procedurë transparente, ndërsa do të ndodh edhe identifikimi i hapësirave publike bashkë me iniciativat për menaxhimin e tyre, duke r krijuar kështu edhe një rregullore për përdorimin e tyre për aktivitete kulturore dhe shoqërore nga shoqëria civile.</p>

Bashkëfinancuar nga: